



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PËRFAQËSUESVE TË TELEVISIONIT AL JAZEERA NË
ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Miratimi i gazetarëve dhe operatorëve të paraqitur nga televizioni Al Jazeera për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 6, pika 2, 4, 5, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave"

V Ë R E N

Televizioni Al Jazeera ka paraqitur kërkesën e tij me nr. Prot 12335 të datës 26.06.2019, bashkë me dokumentacionin mbështetës pranë KQZ për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve dhe operatorëve.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5 e Kodit Zgjedhor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 4 të Udhëzimit nr.13 datë 22.04.2009 të KQZ "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare



Nr. 888 i Vendimit

Data 27.06.2019

Ora 10 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e gazetarëve dhe operatorëve të televizionit Al Jazeera për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor,

2019

shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave".

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 6 , pika 2, 4, 5 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 13, datë 22.04.2009 "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja dhe mediave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve:

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e televizionit Al Jazeera, për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve dhe operatorëve, për vëzhgimin e procesit zgjedhor pranë KZAZ-ve të Bashkisë Vlorë , për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 Qershor 2019, sipas listës të përcaktuar në lidhjen Nr.4, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 888 i Vendimit

Data 27.06.2019

Ora 10 .⁰⁰ e Vendimit

Për miratimin e gazetarëve dhe operatorëve të televizionit Al Jazeera për vëzhgimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor,

2019